

BASHKIA SKRAPAR
NJOFTIM PËR DHËNIE ME QERA

1. Autoriteti: Bashkia Skrapar
Adresa Sheshi “ARKITEKT KASËMI” , nr.1, 5401, Çorovodë, SKRAPAR
Tel/Fax 031222512
Email - bashkiacorovode@ymail.com
Adresa e ëeb-faqes: bashkiaskrapar.gov.al

2. Dhënie me qira të fondit kullosor në përdorim, me konkurim publik në pronësi të Bashkisë Skrapar, sipas të dhënave të mëposhtme:

Njësia Administrative Zhepë, Ekonomia kullosore Dobrenjë-Gjogovicë

Nr.	Njësia Administrative	Zona kadastrale	Nr. Pasurisë	Nr. Parcelës Pyjore	Objekti i veprimtarisë	Sipërfaqja		Vlera dysheme e qirasë Lekë/vit/ha	Kohëzgjatja (Vite)
						ha	km		
Loti I-re	Zhepë Ekonomia kullosore Dobrenjë-Gjogovicë	1419	100	12	Për zhvillim ekonomik, në fushën e	60		132 000	10
		1419	110	17		80			

					energji të rinovuesh me, etj.				
--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

3. Qëllimi i dhënies me qira të fondit pyjor dhe kullosor, me konkurim publik në pronësi të Bashkisë Skrapar ,është dhënia në përdorim për zhvillim ekonomik, në fushën e energji të rinovueshme, etj.
4. Konkurrimi do të zhvillohet më datë: 22.12.2025, ora 11:00, në Salla e mbledhjeve, Bashkia Skrapar.
5. Çmimi dysheme i qirasë, është Kullotë: 132 000 (Njëqind e tridhjetë e dy mijë)lekë/ha në vit.
6. Afati i dhënies me qira të kësaj pasurie do të jetë 10 (dhjetë) vjet.
7. Ofertuesit janë të lutur të paraqesin vetëm një ofertë, në datën dhe orën e caktuar, dhe dokumentacionin si vijon :
8. Kërkesë së bashku me të dhënat për gjeneralitetet e tyre;
9. Sigurimi i ofertës
 - a) Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Formularin e Sigurimit të Ofertës, Shuma e kërkuar e sigurimit të ofertës duhet të jetë sa 2% e vlerës së fondit limit. Llogaritja : Vlera e qirasë X ha X vitet e qirasë X 2%.
 - b) Certifikatën e regjistrimit dhe Ekstraktin e regjistrimit në QKB për objektin e veprimtarisë,
 - c) Projektin teknik të hartuar nga specialistë të licencuar ku janë trajtuar të gjithë elementët e nevojshëm për zhvillimin e veprimtarisë së kërkuar, (i cili përmban hartën topografike me koordinatat e sipërfaqes objekt përdorimi në variantin PDF dhe në format elektronik në shkallë 1:10.000,ku të jenë evidentuar elementët kryesorë, si kufijtë natyrorë, relievi, objektet aktuale, si dhe çdo planimetri tjetër në shkallë më të detajuar, hartuar konform kërkesave të projektit);
 - d) Plan biznesin dhe investimet që do të bëhen;
 - e) Të dhënat për kapacitetet teknike, stafin makineritë dhe pajisjet që zotëron;
 - f) Planin e rehabilitimit të sipërfaqes dhe kthimin e saj në gjendjen e mëparshme;
 - g) Nivelin e punësimit në veprimtari;
 - h) Raportin e vlerësimit të ndikimit mjedis nga ekspertë të certifikuar;
 - i) Çmimin e qerasë së ofruar për ha/vit;
 - j) Afati i qirasë.
 - k) Adresës e subjektit,telefonin,e-mail dhe faks.
 - l) Të ketë të kontraktuar një specialist të fushës , ku në CV – në profesionale të tregohet përvoja në fushën e veprimtarisë.
 - m) Vërtetim nga organet përkatëse shtetërore se subjekti nuk ka procese gjyqësore në ngarkim, hetim në proces, detyrime tatimore ose detyrime të tjera ndaj të tretëve.
 - n) Vërtetim për shlyerjen e taksave, tarifave dhe detyrimeve vendore për vitin 2024 duke mbajtur në konsideratë edhe përcaktimet e Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, ku ushtron/jnë aktivitetin.

- o) Deklaratë se mban përgjegjësi ligjore për vërtetësinë e deklarimeve në dokumentacionin e dorëzuar në konkurrim. Në rast konstatimi të të dhënave të rreme, në çdo rast, Komisioni s'kualifikon subjektin konkurrues.
9. Vlerësimi i ofertave konkurruese do të bëhet me pikë si vijon:
- projekti teknik i veprimtarisë që do të ushtrohet, i cili përmban hartën topografike me koordinatat e sipërfaqes objekt përdorimi në variantin PDF dhe në format elektronik në shkallë 1:10 000 ku të jenë evidentuar elementet kryesore, si: kufijtë natyrorë, relievi, objektet aktuale, si dhe çdo planimetri tjetër në shkallë më të detajuar, hartuar konform kërkesave të projektit 20 pikë
 - plan biznesi dhe investimet që do të bëhen 15 pikë
 - planin e rehabilitimit të sipërfaqes 25 pikë
 - nivelin e punësimit në veprimtari 5 pikë
 - masën e qirasë për ha/vit 35 pikë
10. Dokumentacioni duhet të paraqitet në zarf të mbyllur, të nënshkruar nga konkurruesi me mbishkrimin "Ofertë për dhënie përdorim", dhe i dorëzohen komisionit për vlerësimin e dokumentacionit, në orën e hapjes së procedurës së konkurrimit.

Mosparaqitja e njërit prej dokumenteve të mësipërme ose paraqitja e dokumenteve të rreme, përbën kusht skualifikues.